

1718



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Datë/a:	19.12.2023
Referenc-ë	Titulli: „ Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve “ Nr i prokurimit 616-22-2435-2-1-1 Nr i brendshëm 616 22 026 211
Për/ Za/ To:	Përparim Rama Zyrtar Kryesor Administrativ
Nga/ Od/ From:	Visar Shehu U.D Udhëheqës I Departamentit të Prokurimit
Tema/ Subjekat/Subject:	KONTRATA

Titulli: „ Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”,

Me respekt

Departamenti i Prokurimit !



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

616-22-2435-2-1-1/C1361

Data: 26/12/2023

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Grup i Operatorëve Ekonomik Uplift L.L.C.; INTRAST SH.P.K., Rruga Vicianum, Prishtinë, regjistrimin e biznesit unik 811856965 e përfaqësuar nga Florid Neziraj-Drejtor menagjues, në tekstin e mëtejme ("Kryesi i punëve"), janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për punët të shënuara me poshtë:

Titulli: „ Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve “

Nr1 i prokurimit	616-22-2435-2-1-1
Nr i brendshëm	616 22 026 211

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **“Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve “**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon për 36 MUAJ

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 5 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Prishtinë

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimit **Vlera totale indikativë(Vlera e parashikuar) e kontratës është 600.000,00Euro.**(Një milion e treqinde e pesëdhjetë mijë euro e zero euro cent) çmimi total i poentuar është 6,251.95€.

Duke qenë se në këtë Kontratë, në pajtim me dispozitat e nenit 52 pika 6 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092LPP-së dhe nenin 56 pika 11 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik nuk është përcaktuar ndonjë limit financiar dhe / ose sasi apo devijim i lejuar nga vlera e parashikuar e kontratës, Menaxheri i Kontratës duhet ta arsyetoj bindshëm tejkalimin e shpenzimit të vlerës së parashikuar të Kontratës në rast se vlera e parashikuar ndryshon në mënyrë substanciale.

Peshimi i artikuj-ve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i Kontratës mbetet përgjegjëse që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të Autoritetit Kontraktues

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.






Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët ² në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues				Për Kontraktuesin	
Drejtore I prokurimit		Zyrtari Kryesor Administrativ			
Emri:	Visar Shehu	Emri:	Përparim Rama	Emri:	Florid Nezirej
Pozita:	Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit	Pozita:	Kryetar i Komunës	Pozita:	zv. Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.12.2023	Data:		Data:	26.12.23
Vula:		Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruar ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amendamentit/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Fillimi dhe Ekzekutimi shërbimeve	6.1	Data e fillimit të implementimit të kontratës është 15 dite pas nënshkrimit të kontratës
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të ZKA-se.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 60,000.00 € për 37 muajsh.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar. (c) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar - e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Kërkesat për pagese do të bëhen për punët e përfunduara në baza mujore (ex post). Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për punët e përfunduara në baza mujore (ex post). Në bazë të konstatimit të Menagjerit dhe ekipit mbikëqyrës. - Nuk ka pagese paraprake.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>Inspektimi do të bëhet nga persona të caktuar nga ZKA.</i> Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është 12 muaj pas lëshimit të certifikatës së përdorimit të ashensorit nga certifikuesi i licencuar.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën komerciale në pajtim me ligjin në Kosovë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</i>

RREGULLIMI DHE RIPARIMI I ASHENSORËVE					
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Shuma me TVSH
A)				A) totali (70% + përveç 30%)	
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tabelës komanduese elektronike me frekuencë dhe me mundësi ndalesë në kate nëse ndërpreritet rryma.	copë	1	1,200.00 €	1,200.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i litarëve Ø 9, 10, 11, 12, 13 mm	m'	1	27.50 €	27.50 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i pullegjës për litar Ø 9, 10, 11, 12, 13 mm	copë	1	26.00 €	25.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe instalimi elektrik komandues në dhomën makinerike dhe nëpër etazhe (kate)	etazhe	1	460.00 €	450.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i butonave thirrës të brendshme dhe të jashtme	copë	1	126.00 €	125.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i pirunëve (kontaktore) femëror dhe mashkullor.	copë	1	75.00 €	75.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i deryve të brendshme (kabinës)	copë	1	300.00 €	300.00 €
8	Furnizimi, transporti dhe montimi i kufitareve	copë	1	85.00 €	85.00 €
9	Izolimi i kulmit të shtëpizës së ashensorit (ter letër, bitumen, zhavorr)	m²	1	50.00 €	50.00 €
10	Riparimi i mth deryve të jashtme të ashensorit sipas dimensioneve ekzistuese në kate.	derë	1	200.00 €	200.00 €
11	Furnizimi, transporti dhe ndërimi i vajit të reduktorit	litër	1	3.00 €	3.00 €
12	Furnizimi, transporti dhe montimi i elektromotorit me frekuencë në vend të atij me dy shpejtësi si dhe bazamenti i tij.	copë	1	1,250.00 €	1,250.00 €
13	Furnizimi, transporti dhe montimi i displejëve në dyert e pusores për qdo etazhë e cila tregon pozitën dhe kahjen e lëvizjes së ashensorit	copë	1	145.00 €	145.00 €
14	Riparimi i elektromotorit (mbështjellja, vinklimi)	copë	1	160.00 €	150.00 €
15	Riparimi gjegjësisht ndërimi i rregullatorit të litarit	copë	1	120.00 €	120.00 €
16	Riparimi gjegjësisht ndërimi i sistemit të frenimit	copë	1	125.00 €	125.00 €
17	Furnizimi, transporti dhe montimi i mekanizmit qendror për hapjen dhe mbylljen e deryve.Cz	copë	1	60.00 €	50.00 €
18	Furnizimi, transporti dhe montimi i rreshqitësit	copë	1	126.00 €	125.00 €
19	Furnizimi, transporti dhe montimi i kundër peshës të ashensorit me dimensione ekzistuese	copë	1	50.00 €	50.00 €
20	Furnizimi, transporti dhe montimi i sistemit të frenimit nën kabinën e ashensorit.	copë	1	75.00 €	75.00 €
21	Furnizimi, transporti dhe montimi i deryve të jashtme gjysmë automatike (thatë) me dimensione min 70 deri në max 90cm.	derë	1	750.00 €	750.00 €
22	Demontimi i deryve ekzistuese sipas dimensioneve që janë dhe bartja deri në deponi të mbeturinave.	derë	1	5.00 €	5.00 €
23	Furnizimi, transporti dhe montimi i ndriqesit LED.	copë	1	5.00 €	5.00 €
24	Furnizimi, transporti dhe montimi i kabllos 3x1.5mm²CU.	m'	1	3.00 €	3.00 €
25	Furnizimi, transporti i pasqyrës, mbajtësit si dhe pastrimi i kabinës.	komplet	1	60.00 €	50.00 €
26	Pastrimi i pusores dhe i dhomës makinerike	copë	1	60.00 €	50.00 €
27	Rregullimi i tabelës kryesore të rrymës	copë	1	26.00 €	25.00 €
28	Furnizimi, transporti dhe montimi i ndërprerësit të fuqisë në grupin "H".	copë	1	26.00 €	25.00 €
29	Riparimi gjegjësisht ndërimi i ventilatorit të elektromotorit	copë	1	15.00 €	15.00 €
30	Demontimi i kabinës ekzistuese me të gjitha materialet mbrenda si dhe bartja deri në deponi.	kabinë	1	26.00 €	25.00 €
31	Furnizimi, transporti dhe montimi i udhëzueses për lëvizjen e kabinës	copë	1	120.00 €	120.00 €
32	Furnizimi, transporti dhe montimi i udhëzueses për kundërpesha	copë	1	120.00 €	120.00 €
33	Furnizimi, transporti dhe montimi i kabinës së liftit.	kabinë	1	800.00 €	800.00 €
34	Furnizimi, transporti dhe montimi i operatorit për dyer të ashensorit me dimensionet 70 cm 80 cm 90 cm 100 cm tipi selcom ose fermator	copë	1	200.00 €	200.00 €
35	Furnizimi, transporti dhe montimi i 4 shkarkuesëve të mbtensionit me tension të durimit deri në 500V dhe rrymë të durimit deri 5kA	copë	1	20.00 €	20.00 €
36	Shqyrtimi i i pjesës dinamike dhe statike të ashensorëve (e cila bëhet nga kompania e licencuar)	copë	1	200.00 €	200.00 €
37	Furnizimi, transporti dhe montimi i binarëve të ashensorëve.	m'	1	76.00 €	75.00 €

38	Furnizimi, transporti dhe montimi i vagës për mbingarkesë	copë	1	125.00 €	125.00 €
39	Furnizimi, transporti dhe montimi i mbrojtjes në kundërpeshë në llamarinë.	copë	1	50.00 €	50.00 €
40	Furnizimi, transporti dhe montimi i mbledhësit të vajit në shina.	copë	1	25.00 €	25.00 €
41	Furnizimi, transporti dhe montimi i gardhit mbrojtës mbi kabinë	copë	1	150.00 €	150.00 €
42	Furnizimi, transporti dhe montimi i aparatit kundër zjarrit	copë	1	50.00 €	50.00 €
43	Furnizimi, transporti dhe montimi i siguresave të kundër peshës	copë	1	75.00 €	75.00 €
44	Furnizimi, transporti dhe montimi i paisjes për vozitje manuale në PIt (Stopi, Priza 220V, Butonat për vozitje manuale posht nalt, alarmi dhe butoni resetues).	copë	1	150.00 €	150.00 €
45	Furnizimi, transporti dhe montimi i kontrollit të qasjes me kartela për Ashensorë.	komplet	1	80.00 €	80.00 €
				Total A:	7,823.50 €
				B: Totali i (30% e p.këve për vlerësim)	
46	Furnizimi, transporti dhe montimi i pompës hidraulike.	copë	1	500.00 €	500.00 €
47	Furnizimi, transporti dhe montimi i elektromotorit hidraulik.	copë	1	250.00 €	250.00 €
48	Furnizimi, transporti dhe montimi i valvulave hidraulike.	copë	1	50.00 €	50.00 €
49	Furnizimi, transporti dhe montimi i vajit Hidraulik Hidrol 68vp.	litër	1	5.00 €	5.00 €
50	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypit hidraulik.	m'	1	5.00 €	5.00 €
51	Furnizimi, transporti dhe montimi i cilindrit për ashensorin hidraulik. Trashësia e murit, presioni statik dhe dimensionet i jashtëm definohej para porosisë	copë	1	125.00 €	125.00 €
52	Furnizimi, transporti dhe montimi i pistonit për ashensorë hidraulik. Trashësia e murit, presioni statik dhe dimensionet i jashtëm definohej para porosisë	copë	1	125.00 €	125.00 €
53	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyerve të kabinës, automatike teleskopike-me rregullim frekuencor.	copë	1	500.00 €	500.00 €
54	Furnizimi, transporti dhe montimi i lyeses univerzale për lubrifikim.	copë	1	75.00 €	75.00 €
55	Furnizimi, transporti dhe montimi i modulit elektronik për komandim me ashensorë.	copë	1	350.00 €	350.00 €
56	Furnizimi, transporti dhe montimi i bllokut (komplet) të dhenësit magnetik.	copë	1	200.00 €	200.00 €
57	Servisi i ashensorëve, në Institucione Komunale. Llogaritja vetëm për një ashensorë-herë.	herë	1	400.00 €	400.00 €
				Totali B:	2,585.00 €

REKAPITULLIM		Çmimi total	Çmimi total i peshuar
A - Gjithsej (1-45):70%		€ 7,823.50	€ 5,476.45
B - Gjithsej (46-57) :30%		€ 2,585.00	€ 775.50
Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shënohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.			€ 6,251.95



Për: KUVENDI KOMUNAL I PRISHTINËS
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: Uplift L.L.C., Vicianum, C2.2, H1, Nr 23, Prishtine
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: RREGULLIMI DHE RIPARIMI I ASHENSOREVE

Numri i prokurimit: 616-22-2435-2-1-1 (numri i brendshëm 616 22 026 211)

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Garancion

Nr.Serik i polices: 666/23

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;
DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit;
DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë-nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **60,000.00 (gjashtëdhjetë mijë Euro)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos pëmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **60,000.00 Euro** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri është e vlefshme 1127 ditë prej 26.12.2023 deri më 25.01.2027

Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.a.
Rruga "2 Korriku", Nr.4, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data: 26.12.2023



030506

**POLICA E SIGURIMIT TË RREZIQEVE
NË NDËRTIM (CAR)**
CONTRACTOR'S ALL RISK INSURANCE POLICY

 Nr.policës
Policy No

5/23

Emri i të siguruarit	Uplift L.L.C.	Emri i investitorit	Kuvendi Komunal i Prishtinës
Personi i autorizuar	BARDH HOTI	Numri fiskal	
Numri fiskal		Sheshi i ndërtimit	PRISHTINE
Adresa e drejtorisë:	Vicianum, C2.2, H1, Nr 23	Numri i kontratës	616-22-2435-2-1-1 (numri i brendshem
Titulli i kontratës	RREGULLIMI DHE RIPARIMI I ASHENSOREVE		
SEKSIONI 1 DËMI MATERIAL	ARTIKUJT E SIGURUAR	SHUMAT E SIGURUARA	PJESA E ZBRITSHME
	1 PUNIME TË KONTRAKTUARA		
	1.1 PUNIME TË PËRHERSHME E TË PËRKOSSHME, PËRFSHIRË MATERIALET	15,000.00	10 %
	2 IMPIANTE E PAISJE NDËRTIMI	0.00	
	3 MAKINERI NDËRTIMI (SIPAS LISTËS)	0.00	
	4 PASTRIMI I MBETURINAVE	0.00	
	Shuma totale e siguruar sipas Seksionit 1	15,000.00	10 %
	RREZIKU	KUFIDTË E DËMSPËRBLIMIT	PJESA E ZBRITSHME
	TËRMETI, PËRMBYTJA, VËRSHIMI, FURTUNA, STUHIA, RRËSHQITJE TOKE	50,000.00	10 %
SEKSIONI 2 PËRGJEGJËSIA NDAJ PALËVE TË TRETA	ARTIKUJT E SIGURUAR	SHUMAT E SIGURUARA	PJESA E ZBRITSHME
	1. LIMITI I DËMSPËRBLIMIT PËR LËNDIME TRUPORE PËR NJË NGJARJE	50,000.00	10 %
	2. LIMITI I DËMSPËRBLIMIT PËR DËME MATERIALE PËR NJË NGJARJE	15,000.00	10 %
	LIMITI I PËRGJITHSHËM I DËMSPËRBLIMIT	65,000.00	10 %
PRIMI I SIGURIMIT	337.50 Euro	SIGURIMI FILLON MË	27.12.2023 00:00
TVSH	60.75 Euro	SIGURIMI MBARON MË	26.12.2024 24:00
SHUMA PËR PAGESË	398.25 Euro	DATA E LËSHIMIT	26.12.2023 12:59:08

Pasi lexova dhe i kuptova kushtet bashkangjitur të kësaj kontrate sigurimi, deklaroj se pajtohem me to dhe të dhënat e kësaj police dhe nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë dhe të plotë.



CONTRACTORS' ALL RISKS POLICY

Pasi i Siguruari, përmendur në Formular i ka drejtuar Kompanisë së Sigurimeve "Eurosig" Sh.a. (këtu më poshtë i quajtur "Siguruesi") një kërkesë me shkrim duke plotësuar një Pyetësor, i cili së bashku me çdo deklaratë tjetër të bërë me shkrim nga i Siguruari në lidhje me këtë Policë konsiderohen të përfshira në të, atëherë kjo Policë Sigurimi dëshmon se, me kusht që i Siguruari t'i ketë paguar Siguruesit primin e përmendur në Formular dhe të veprojë sipas kushteve, përjashtimeve dhe klauzolave të përmbajtura në Policë ose të shtuara në të, Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin në mënyrën dhe masën e parashikuar si më poshtë.

Primi i sigurimit ose kësti i parë i tij duhet paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së sigurimit. Në rast se i Siguruari nuk paguan këstin pasardhës në kohën e caktuar, atëherë Siguruesi ka të drejtë të perfundojë marrëdhëniet siguruese. Në rast se, Siguruesi do të mbajë përgjegjësi për dëmet e pësuar gjatë periudhës që Polica ka qenë në fuqi, Siguruesi do të dëmshpërblejë dëmin në përpjestim me shumën e primit të paguar.

Përjashtimet e Përgjithshme

Siguruesi nuk do të dëmshpërblejë të Siguruarin për humbje, dëmtime apo përgjegjësi që, në mënyrë direkte ose indirekte janë shkaktuar, rrjedhin ose janë shtuar nga:

- a) Lufta, invazioni, veprime të armikut të jashtëm, veprime luftarake (pavarësisht nëse është shpallur lufta apo jo), lufta civile, rebelimi, revolucioni, revolta, kryengritje, trazira, greva, turbullira civile, pushteti ushtarak ose i uzurpuar, një grup personash keqdashës ose personash që veprojnë në emër ose në lidhje me çdo organizatë politike, komploti, konfiskimi, veprimi i komandove, rekuizimi, shkatërimet apo dëmtimet e kryera me urdhër të çdo lloj qeverie apo autoriteti shtetëror.
- b) Shpërthimi bërthamor, rrezatimi bërthamor apo ndotja radioaktive.
- c) Veprimet e qëllimshme ose pakujdesia e rendë e të Siguruarit ose e përfaqësuesve të tij.
- d) Ndërprerja e plotë ose e pjesëshme e punës.

Në çdo padi kërkesë ose procedurë tjetër gjyqësore ku Siguruesi pohon se bazuar në klauzolat e mësipërme të përjashtimeve, se humbja, shkatërimi, dëmtimi apo përgjegjësia nuk mbulohen nga ky sigurim, barra për të provuar që humbja, shkatërimi, dëmtimi ose përgjegjësia janë të mbuluara do t'i bjerë të Siguruarit.

Periudha e Mbulimit

Përgjegjësia e Siguruesit do të fillojë, pavarësisht se data mund të jetë caktuar ndryshe në Formular, menjëherë me fillimin e punës ose pas shkarkimit të artikujve të përmendur në Formular në vendin e punës.

Përgjegjësia e Siguruesit përfundon për pjesët e punimeve të siguruar që janë dorëzuar dhe vënë në shërbim. Afati më i fundit i përfundimit të mbulimit në sigurim është data e përcaktuar në Formular. Çdo shtim i periudhës së Sigurimit mund të bëhet vetëm duke u miratuar më parë me shkrim nga Siguruesi.

Kushte të Përgjithshme

1. Respektimi dhe plotësimi domosdoshmërisht i kushteve të kesaj Police nga ana e të Siguruarit dhe vërtetësia e deklaratave dhe e përgjigjeve që i Siguruari ka dhënë në Pyetësorin dhe kërkesën e plotësuar prej tij do të jetë kusht paraprak për çdo përgjegjësi të Siguruesit.

2. Formulari dhe Seksioni(et) do të konsiderohen të përfshira në Policë dhe pjesë të saj dhe shprehja "Kjo Policë" kudo që është përdorur do të kuptohet se në të janë përfshirë Formulari dhe Seksioni(et). Çdo fjalë ose shprehje së cilës i është dhënë një kuptim i caktuar në ndonjë pjesë të kesaj Police ose Formulari ose Seksioni(et) do të mbajë këtë kuptim kudo që të shfaqet.

3. I Siguruari me shpenzimet e tij do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe do të veprojë në përputhje me rekomandimet e duhura të Siguruesit për të parandaluar humbjen, dëmtimin ose përgjegjësinë dhe për të zbatuar kërkesat ligjore dhe rekomandimet e prodhuesit.

4. a) Përfaqësuesit e Siguruesit kanë të drejtën që të inspektojnë dhe të kontrollojnë rrezikun në çdo kohë që do ta shohin të përshtatshme dhe i Siguruari do t'i japë përfaqësuesve të Siguruesit të gjitha detajet dhe informacionin e nevojshëm për vlerësimin e rrezikut.

b) I Siguruari do të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesin, për çdo ndryshim të rrezikut dhe me shpenzimet e tij do të marrë të gjitha masat që kërkojnë rrethanat. Fusha e mbulimit dhe/ose primi, nëse është e nevojshme, do të ndryshojnë në përputhje me kushtet e reja. Asnjë ndryshim nuk do të bëhet ose lejohet nga i Siguruari kurdoherë që rreziku rritet, pa konfirmimin me shkrim të Siguruesit për vazhdimësinë e sigurimit.

5. Në rast të ndodhjes të një ngjarje që çon në një kërkesë për dëmshpërblim sipas kesaj Police, i Siguruari do të:

- a) Njoftojë menjëherë Siguruesin me shkrim, duke përcaktuar natyrën dhe shtrirjen e humbjes ose dëmit.
- b) Marrë të gjitha masat brenda mundësive, për të minimizuar zgjerimin e humbjes ose dëmit.

c) Ruajë pjesët e prekura dhe t'i vërë ato në dispozicion për inspektim, përfaqësuesit apo mbikqyrësit të Siguruesit.

d) Japë të gjithë informacionin dhe dëshmitë dokumentare, që mund të kërkojë Siguruesi.

e) Informojë Autoritetet e Policisë, në rast të humbjes apo dëmtimit, për shkak të vjedhjes me thyerje apo grabitjes.

Siguruesi në çdo rast, nuk do të jetë përgjegjës për humbjen, dëmin ose përgjegjësinë për të cilat nuk ka marrë njoftim me shkrim, brenda 14 ditësh nga momenti i ngjarjes.

Me dhënien e njoftimit Siguruesit, sipas këtij kushti, i Siguruari mund të kryejë riparimin ose zëvendësimin e dëmeve me përmasa të vogla. Në të gjitha rastet e tjera, do t'i jepet mundësia përfaqësuesit të Siguruesit për të inspektuar humbjen ose dëmin, më parë se të kryhet çdo riparim ose ndryshim. Nëse përfaqësuesi i Siguruesit nuk kryen inspektimin brenda një periudhe kohe që mund të konsiderohet e mjaftueshme sipas rrethanave, atëherë të Siguruarit i jepet e drejta të fillojë riparimin ose zëvendësimin. Përgjegjësia e Siguruesit, sipas kesaj Police, për sa i përket çdo artikulli të dëmtuar do të pushojë nëse artikulli i përmendur nuk riparohet tërësisht dhe pa vonesë.

6. I Siguruari, me shpenzimet e Siguruesit, do të kryejë dhe do të bashkëveprojë në kryerjen dhe do të lejojë të kryhen të gjitha ato veprime, që mund të jenë të nevojshme ose të kërkuara nga Siguruesi, në interes të çdo të drejte ose mjeti, ose përfitim të dëmshpërblimit të pjesshëm ose të plotë, prej palëve (përveç atyre që janë të siguruar sipas kesaj Police) tek të cilat Siguruesi ka ose do të ketë të drejtën për t'u paguar ose përfutur nga çdo humbje ose dëm sipas kesaj Police, nëse këto veprime ose çështje janë ose bëhen të nevojshme ose kërkojnë para ose pas dëmshpërblimit të të Siguruarit nga Siguruesi.

7. Mosmarrëveshjet ndërmjet Siguruesit dhe të Siguruarit, që rrjedhin nga marrëdhëniet e sigurimit, do të zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

8. Nëse një kërkesë për dëmshpërblim përmban mashtrim, ose në mbështetje të kërkesës është bërë ose përdorur ndonjë deklaratim fals, ose nga i Siguruari apo dikush tjetër që vepron në emër të tij janë përdorur mënyra apo mjete mashtruese për të përfutur sipas kesaj Police, ose nëse kërkesa për dëmshpërblim është refuzuar dhe brenda tre muajve nuk ka filluar asnjë veprim apo padi, çdo përfitim sipas kesaj Police do të humbasë.

9. Nëse në momentin që ndodh ngjarja e sigurimit sipas kesaj Police, ekziston mbulim tjetër për të njëjtin humbje, dëm apo përgjegjësi, Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për të paguar më shumë se pjesa që i takon në këtë humbje, dëm ose përgjegjësi.

10. Pas çdo ndodhje të një ngjarjeje sigurimi, si i Siguruari ashtu dhe Siguruesi, ka të drejtë të ndërpresin kontratën e sigurimit. Ndërprerja mund të bëhet brenda dy javësh pas përfundimit të bisedimeve për dëmshpërblimin, duke i dërguar njoftimin me shkrim palës tjetër. Ndërprerja hyn në fuqi dy javë pasi të jetë marrë njoftimi nga pala tjetër.

11. Nëse kontrata e sigurimit ndërpritet nga i Siguruari, Siguruesi ka të drejtë të mbajë primin e sigurimit për periudhën vijuese. Nëse kontrata e sigurimit ndërpritet nga Siguruesi, zbatohet parimi i mësipërm për sa i përket pjesës së primit të sigurimit, që i korrespondon dëmshpërblimit të paguar dhe pjesës së primit që i korrespondon periudhës së sigurimit përpara ndërprerjes së kontratës.

Anulimi

Kjo Policë mund të përfundojë në çdo kohë me kërkesë të të Siguruarit dhe në këtë rast Siguruesi do të mbajë primin për kohën që Polica ka qenë në fuqi, si dhe 20% të primit të sigurimit të pashfrytëzuar për shpenzime administrative. Primi i mbetur do të kthehet vetëm në rast se nuk ka pasur dëme të paraqitura.

Kjo Policë gjithashtu mund të përfundojë në çdo kohë me dëshirën e Siguruesit duke njoftuar të Siguruarin lidhur me këtë ndërprerje dhe në këtë rast Siguruesi do të jetë i detyruar të kthejë primin në proporcion me kohën e mbetur nga anulimi i Policës deri në përfundim të saj.

Seksioni I – Dëmi Material

Siguruesi dhe i Siguruari bien dakort se, nëse në çdo kohë gjatë periudhës së sigurimit, zërat ose çdo pjesë tjetër e përfshirë në Formular do të pësojë dëm ose humbje fizike të paparashikuar dhe të papritur nga shkaqe, përveç atyre të përjashtuara shprehimisht, dëm ose humbje që bëjnë të domosdoshme riparimin ose zëvendësimin, Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin për këto dëme ose humbje duke paguar me para, duke riparuar ose zëvendësuar (sipas zgjedhjes së vet), deri në një shumë që për çdo ngjarje nuk kalon kufirin e dëmshpërblimit të zbatueshëm dhe në përgjithësi nuk kalon shumën e përgjithshme të shprehur në Formular.

Siguruesi do t'i paguajë gjithashtu të Siguruarit shpenzimet për pastrimin e mbeturinave, që janë pasojë e çdo ngjarje me rrjedhojë lindjen e një kërkesë për dëmshpërblim sipas kesaj Police, me kusht që për këtë rast të jetë përfshirë në Formular një shumë e veçantë.

Përjashtime të Vecanta në Seksionin I

4. Shpenzimet e zëvendësimit, riparimit ose ndreqjes të materialeve apo punimeve difektoze, por ky përjashtim do të kufizohet në elementet e prekura dhe nuk do të përjashtojë humbjen ose dëmtimin e elementeve të kryera rregullisht që rrjedhin nga ndodhja e një aksidenti për shkak të materialeve dhe/ose punimeve defektoze.

5. Konsumimin, korrozionin, oksidimin, uljen e cilësisë për shkak të mospërdorimit dhe kushteve atmosferike normale.

6. Avaritë mekanike dhe/ose elektrike ose çrregullimet e impianteve ndërtuese, paisjeve dhe makinerive të ndërtimit.

7. Humbjen dhe ndërtimin e automjeteve të pajisura me leje qarkullimi rugor apo anijeve, apo avionëve.

8. Humbjen ose dëmtimin e skedarëve, vizatimeve, llogarive, faturave, parave, pullave, akteve, dëshmime të debiteve, shënimeve, letrave me vlerë, çeqeve.

9. Humbjen ose dëmtimin e zbuluar në kohën e kryerjes së inventarit.

Klauzola për Seksionin I

Kujtesë 1 - Shumat e Siguruara: Është kërkesë thelbësore e këtij sigurimi që shumat e siguruar të përcaktuara në Formular të jenë më të vogla se:

Për zërin 1: Vlera e plotë e punimeve të kontraktuara në përfundimin e ndërtimit, përfshirë të gjitha materialet, pagat, shpenzimet e transportit, detyrimet doganore, tatimet dhe materialet apo artikujt e furnizuar nga investitori.

Për zërin 2 dhe 3: Vlera e zëvendësimit e impiantit ndërtues, pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit që kuptojnë shpenzimet e zëvendësimit të artikujve të siguruar me artikuj të rinj të të njëjtit lloj dhe kapacitet.

dhe i Siguruarit merr përsipër të risë ose të zvogëlojë shumat e siguruar në rast ndryshimi të ndjeshëm në pagat dhe çmimet, me kusht që këto rritje ose ulje do të hyjnë në fuqi vetëm pasi këto ndryshime të jenë shënuar në Policë, nga Siguruesi.

Nëse në ndodhjen e një humbjeje ose dëmi, konstatohet se shumat e sigurimit janë më të vogla se shumat që duhet të siguroheshin sipas kërkesave të shprehura më sipër, atëherë shuma që i Siguruarit mund të marrë sipas kësaj Police, do të zvogëlohet në atë përpjestim që shuma e siguruar faktikisht zë ndaj shumave që kërkohen të sigurohen. Çdo objekt dhe zë shpenzimi i nënshtrohet këtij kushti veçanërisht.

Pas pagesës së dëmshpërblimit, objektet ose artikujt mbesin të siguruar deri në fund të kontratës së sigurimit, për diferencë midis shumës së siguruar dhe dëmshpërblimit të paguar, duke bërë për këtë qëllim shënimet përkatëse në Policën e Sigurimit.

Kujtesë 2 - Bazat për përcaktimin e dëmshpërblimit: Në rast të çdo humbje ose dëmi, baza për çdo dëmshpërblim, sipas kësaj Police do të jetë:

a) Në rastin e një dëmi që mund të riparohet – shpenzimet e riparimeve të domosdoshme për të rivendosur artikuj në gjendjen që kishin menjëherë para ndodhjes së dëmtimit, minus pjesën e shpëtuar, ose

b) Në rastin e humbjes së plotë – vlerën aktuale të artikujve menjëherë para ndodhjes së dëmtimit, minus pjesën e shpëtuar, sidoqoftë vetëm në atë masë që shpenzime të tilla duhet të përballohen nga i Siguruarit dhe në masën që janë përfshirë në shumën e siguruar dhe gjithmonë me kusht që të plotësohen klauzolat dhe kushtet.

Siguruesi do të kryejë pagesat vetëm pasi të jetë bindur nga faturat dhe dokumentat e nevojshëm se janë kryer riparimet dhe zëvendësimet në përputhje me kushtet.

Do të riparohet çdo dëm, që mund të riparohet, por nëse shpenzimet e riparimit të dëmit janë të barabarta ose tejkalojnë vlerën e artikujve menjëherë para ndodhjes së dëmit, përcaktimi do të behet sipas pikës "b" më lart.

Shpenzimet e riparimeve të përkohshme do të përballohen nga Siguruesi nëse këto riparime përbëjnë pjesë të riparimeve përfundimtare dhe nuk rrisin shpenzimet e përgjithshme të riparimit.

Nuk mbulohen sipas kësaj police dhe kontrate sigurimi, shpenzimet e çdo ndryshimi, shtesë dhe/ose përmirësimi.

Kujtesë 3 - Shtrirja e Mbulimit: Shpenzimet e veçanta për punë jashtë orarit, punë natën, punë në ditët e pushimit, transportet ekspres, mbulohen nga ky sigurim vetëm nëse për këtë është rënë dakord më parë me shkrim.

Seksioni II – Përgjegjësia ndaj Palëve të Treta

Siguruesi duhet të dëmshpërblejë të Siguruarin jo më shumë se shumat e përcaktuara në Formular, sipas shumave që i Siguruarit do të jetë ligjshëm përgjegjës të paguajë si dëmtime që rrjedhin nga:

a) Dëmtime trupore aksidentale ose sëmundje të paleve të treta (pavarësisht nëse janë fatale apo jo).

b) Humbje apo dëmtime aksidentale të pasurisë që u përket palëve të treta ndodhur në lidhje të drejtëpërdrejtë me ndërtimin ose montimin e artikujve të siguruar, sipas Seksionit I dhe në vendin ose në afërsi të tij gjatë periudhës së sigurimit.

Në lidhje me kërkesën për kompesim ku zbatohet dëmshpërblimi i përcaktuar këtu, Siguruesi do të dëmshpërblejë gjithashtu të Siguruarin për:

a) Të gjitha shpenzimet e padisë që Kërkuesi i merr të Siguruarit, dhe

b) Të gjitha shpenzimet për të cilat Siguruesi ka dhënë miratimin e tij me shkrim, me kusht që përgjegjësia e të Siguruarit, sipas këtij seksioni nuk do të kalojë kufijtë e dëmshpërblimit, e përcaktuar në Formular.

Përjashtime të veçanta në Seksionin II

Siguruesi nuk do të dëmshpërblejë të Siguruarin për:

1. Pjesën e zbritshme, përcaktuar në policën e sigurimit për t'u përballuar nga i Siguruarit në çdo ngjarje.

2. Shpenzimet e bëra për kryerjen, rikryerjen, ndreqjen, riparimin ose zëvendësimin e çdo gjëje të mbuluar ose të mbulueshme, sipas Seksionit I të kësaj police sigurimi.

3. Dëmtimin e pasurisë, tokës apo ndërtesës të shkaktuar nga vibracioni apo nga heqja ose dobësimi i mbajtësve, ose plagosjen apo dëmtimin e personit apo pasurisë, shkaktuar apo që ka ardhur si rrjedhojë e një dëmtimi të tillë (përveç kur është rënë dakord për këtë shtojcë).

4. Përgjegjësinë që rrjedh prej:

a) Lëndimeve trupore ose sëmundjeve të punonjësve apo specialistëve të Kontraktuesve apo Investitorëve ose çdo firme tjetër të lidhur me projektin, i cili ose pjesë e të cilit është siguruar sipas Seksionit I, ose pjestarë të familjeve të tyre.

b) Humbjen ose dëmtimin e pasurisë që i përket ose mban nën kujdes, ruajtje apo kontroll nga Kontraktuesi, Investitori apo çdo firmë tjetër e lidhur me projektin, i cili ose pjesë e të cilit janë siguruar sipas Seksionit I ose një punonjësi apo punëtor i subjekteve të lartpërmendura.

c) Aksidente të shkaktuara nga automjete të pajisura me leje qarkullimi rugor apo avionet ose mjetet lundruese.

d) Çdo marreveshjeje e të Siguruarit për të paguar çdo shumë nepërmjet dëmshpërblimit ose ndryshe në qoftë se kjo përgjegjësi nuk do t'i ishte ngarkuar të Siguruarit gjithashtu në mungesë të kesaj marreveshjeje.

Kushte të veçanta për Seksionin II

1. Asnjë premtim pagese, oferte, pranim pagese ose dëmshpërblim nuk do të bëhet apo jepet nga i Siguruarit pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Siguruesi do të ketë të drejtën, nëse dëshiron të marrë përsipër e drejtë në emër të të Siguruarit, mbrojtjen apo zgjidhjen e çdo kërkesë për dëmshpërblim, ose të ndjekë penalisht për interesin e vet dhe në emër të të Siguruarit çdo kërkesë për dëmshpërblim ose dëm dhe do të ketë liri të plotë veprimi në drejtimin e procesit apo zgjidhjes së çdo kërkesë dhe i Siguruarit do të japë të gjithë informacionin dhe ndihmën që mund t'i kërkojë Siguruesi.

2. Siguruesi për sa i përket çdo aksidenti, mund t'i paguajë të Siguruarit kufirin e dëmshpërblimit për çdo aksident (por duke zbritur prej tij çdo shumë apo shuma që janë paguar tashmë si kompesim), ose shumë më të vogël se sa kufiri i dhënë siç mund të jetë caktuar dhe kështu Siguruesi nuk do të jetë më përgjegjës për këtë aksident, sipas këtij Seksioni.

3. Pasi t'i jetë paguar të Siguruarit dëmshpërblimi për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Siguruesi ka të drejtë t'i kërkojë të Siguruarit primin e plotë të sigurimit ose pjesë të tij, siç mund të paraqitet rasti për ruajtjen e mbulimit në sigurim, me të njëjtin kufi dëmshpërblimi të vendosur në momentin e nënshkrimit të kontratës së sigurimit.

Shtojca 001 - Mbulimi për dëmet për shkak të Grevave, Trazirave dhe Turbullirave Civile (SRCC)

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblitura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të dhe me kusht që pasi i Siguruarit të ketë rënë dakord për të paguar primin shtesë kjo Policë do të zgjerohet për të mbuluar dëmet për shkak të grevave, trazirave dhe turbullirave civile, që sipas qëllimit të kësaj shtojce do të thotë (gjithmonë me kusht që të respektohen Konditat Speciale të përmblitura këtu me poshtë), dëmtim i pasurisë së siguruar e shkaktuar direkt nga:

1. Veprimi i çdo personi që merr pjesë se bashku me disa të tjerë në çdo prishje të qetesise publike (qoftë në lidhje me greven ose me pushimin nga puna ose jo) që nuk është një ngjarje e përmendur në kushtin 2 të Konditave speciale këtu me poshtë;

2. Veprimi i çdo autoriteti ligjor kushtetues për të shtypur ose në perpjekjet për të shtypur çdo trazire të tilla ose veprimet për të minimizuar konsekuencat e kesaj trazire;

3. Veprimi i qellimshëm i çdo grevisti ose i çdo punetori të pushuar nga puna i kryer për të perkratur greven ose për të kundërshtuar pushimi nga puna;

4. Veprimi i ndonjë autoriteti ligjor kushtetues në parandalimin ose në perpjekjen për të parandaluar ndonjë akt të tilla ose në minimizimin e këtij akti.

Me kusht që është shprehur dhe deklaruar shprehimisht se:

1. Të gjithë nenet, përjashtimet, klauzolat dhe kushtet e Polices do të zbatohen në të gjitha drejtëtimet në sigurimin e ofruar nga kjo shtojcë përveç atyre që janë shprehimisht të ndryshuara nepërmjet Konditave Speciale të mëposhtme dhe çdo reference në lidhje me demin në formulimin e Polices do të gjykohej të përfshijë rreziqet të mare prej këtu në sigurim

pasurise se siguruar (pervec pasurise se prodhuar, perpunuar ose magazinuar ne pasurine rrethuese te prodhuesit, shpermdaresit ose furnitorit) te magazinuar larg sheshit te ndertimit brenda territorit te kufizuar sic shpallet me poshte . Siguruesit nuk do te demshperblejne te Siguruarin per humbjen ose demin te shkaktuar nga neglizhimi i masave parandaluese te demit te pranuar ne pergjithesi per magazinat ose njesite e magazinimit.

Te tilla masa ne pergjithesi perfshijne:

- a) Sigurine qe ambienti i magazinimit eshte i mbyllur (qofte ndertese ose se paku shesh i gardhuar), i ruajtur me roje, i mbrojtur kundra zjarrit ashtu sic duhet ne varesi nga vendndodhja e vecante ose tipi i pasurise se magazinuar.
- b) Ndarjen e njesive te magazinimit me mure zjarrruduese ose ndarjen larg njera-tjetres ne nje distance se paku 50 metra
- c) Pozicionimin ose caktimin e njesive te magazinimit ne nje menyre te tille qe te parandaloje demin nga mbledhja e ujrave ose nga permbytja per shkak te rreshjeve ose permbytjes me nje frekuence statistikore perseritese te 20 veteve
- d) Kufizimin e vleres per njesi magazinimi

Kufiri Teritorial:

Vlera maksimale per Njese Magazinimi:

Shtojca 014 - Përjashtimi i humbjes, demit ose përgjegjësisë për shkak të Terrorizmit

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që pavarësisht nga nenet, përjashtimet, klauzolat të përfshira në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesi nuk do të demshperblejë të Siguruarin për humbjen ose demin ose përgjegjësinë që në mënyrë direkte ose indirekte shkaktohen ose vijnë si rezultat i çfarëdo akti terrorist.

Për qëllime të kësaj shtojce një akt terrorist nënkupton aktin, duke përfshirë por jo e kufizuar në përdorimin e forcës ose dhunës dhe/ose kërcënimin prej saj, nga çdo person apo grup personash, qoftë duke vepruar vetëm ose në emër të ose në lidhje me ndonjë organizatë ose qeveri, i kryer për qëllime ose për arsye politike, fetare, ideologjike ose etnike, duke përfshirë qëllimin për të ndikuar në çdo qeveri dhe / ose për të vënë publikun, ose ndonjë pjesë të publikut në frikë. Kjo shtojcë përjashton gjithashtu, humbjen, lëndimin, dëmtimin, kostot ose shpenzimet e çfarëdo natyre, që shkaktohen, rezultojnë apo në lidhje të drejtpërdrejtë ose indirekte me ndonjë veprim të ndërmarrë për kontrollin, parandalimin, shtypjen apo që në ndonjë mënyrë lidhet me aktin terrorist.

Nëse Siguruesi pohon se për shkak të këtij përjashtimi, çdo humbje, lëndim, dëm, kosto ose shpenzim nuk është i mbuluar nga ky sigurim, barra e të provuarit të kundërtën do bjerë mbi të Siguruarin.

Në rast se ndonjë pjesë e kësaj shtojce është gjetur të jetë e pavlefshme ose e pazbatueshme, pjesa tjetër do të mbetet në fuqi dhe me efekt të plotë

Shtojca 100 - Mbulimi për Testimin e Makinerive dhe Instalimeve

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, periudha e mbulimit do të zgjerohet për të përfshirë një prove pune ose një prove ne ngarkese, por me kusht që të mos tejkalohen kater jave nga data e fillimit të proves.

Sidoqofte, ne qofte se nje pjese e implantit ose nje ose disa makineri jane provuar dhe/ose vendosur ne pune ose marre ne dorezim, mbulimi per kete pjese te vecante te implantit ose makinerive dhe çdo pergjegjesi qe rezulton prej tyre nderprehet ndersa mbulimi do te vazhdoje per pjeset e mbetura per te cilat nuk zbatohen kushtet e mesiperme.

Eshte rene dakord dhe pranuar akoma qe per makinerite dhe instalimet te cilat i nenshtrohen proves, perjashtimet "c" dhe "d" te Perjashtimeve te Seksionit 1 te Polices jane hequr dhe do te aplikohet perjashtimi i meposhtem:

"Demi per shkak te projektimit te gabuar, materiali ose derdhja difektoze, profesionalizmi i keq pervec te metave ne montim".

Ne rastin e artikujve te dores se dyte, sigurimi per kete rast, sidoqofte, do te nderpritet menjehere me fillimin e proves.

Shtojca 101 - Kushtet speciale në lidhje me ndërtimin e Tuneleve dhe Galerive

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesi nuk do të demshperblejë të Siguruarin në lidhje me:

- a) Çimentimin e shtresave te buta te shkembit dhe/ose me marjen e masave te tjera shtese te sigurimit edhe ne qofte se behet e nevojshme vetem gjate ndertimit
- b) Tejkallimin e minimumit te germimit perzgjedhjes se shtreses gjate hapjes se tunelit te paraqitur ne projekt dhe shpenzimet shtese te rrjedhura prej andej per rimbushjen e zgavrave
- c) Shpenzimet e kryera per shkarkimin e ujrave edhe ne qofte se sasite e ujrave te prishme shtohen shume me teper
- d) Demin per shkak te shkaterimit te sistemit te shkarkimit te ujrave ne qofte se nje shkaterim i tille mund te shmangej nepermjet pajisjeve rezerve
- e) Shpenzimet e kryera per izolimet ose pajisjet shtese me qellim per te shkarkuar derdhjet dhe/ose ujrane nendheshme

Shtojca 102 - Kushte të veçanta në lidhje me Tubat, Kابلot dhe Pajisjet e tjera Nëntokësore

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesi do të demshperblejë të Siguruarin vetem ne lidhje me demet ne kابلot e nendheshem dhe / ose tubat e nendheshem ose pajisjet e tjera te nendheshme egzistuese ne qofte se, perpara fillimit te punes, i Siguruari i ka kerkuar autoriteteve perkatese nje informacion te sakte per pozicionin e ketyre kابلove, tubave ose pajisjeve te nendheshem dhe ka ndemmarre te gjitha hapat e nevojshem per te eleminuar demet ne to.

Kerkesat per demshperblim ne lidhje me demtimin ne keto pajisje te nendheshme te cilat jane ne te njejtin pozicion siç eshte treguar ne hartat e nendheshme (skicat qe tregojne pozicionin e pajisjeve te nendheshme) do te jene te pagueshme pas aplikimit te nje pjese te zbritshme prej 20% te shumes se demshperblimit.

Kerkesat per demshperblim ne lidhje me demtimin ne pajisjet e nendheshme te paraqitura ne menyre jo korrekte ne hartat e nendheshme do te jene te pagueshme pasi te jete aplikuar pjesa e zbritshme e deklaruar ne pikën " b " të mëposhtme.

Demshperblimi ne çdo rast do te reduktohet ne kostot e riparimit te ketyre kابلove, tubave ose pajisjeve te tjera te nendheshme. Çdo dëm vijues dhe gjobjekt jane te perjashtuar nga ky mbulim.

Pjesa e Zbritshme: "b" _____%, minimumi _____

Shtojca 103 - Përjashtimi i humbjes ose përgjegjësisë në Kulturat Bujqësore dhe Pyjet

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesi nuk do të demshperblejë të Siguruarin per humbjen demin ose pergjegjesine qe ne menyre direkte ose indirekte i eshte shkaktuar ne te mbjellat, pyjet dhe cdo kulture tjeter bujqesore, gjate periudhes se zbatimit te punimeve te kontrates.

Shtojca 104 - Kushte të veçanta në lidhje me Digat dhe Rezervuarat e Ujit

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesi nuk do të demshperblejë të Siguruarin ne lidhje me

- a) Çimentimin e ambienteve te buta shkembore dhe/ose masat e tjera te sigurimit shtese edhe nese behet e nevojshme gjate periudhes së ndertimit;
- b) Shpenzimet e kryera per shkarkimin e ujrave edhe ne qofte se sasite e prishme te ujrave shtohen shume teper;
- c) Demin per shkak te shkaterimit te sistemit te shkarkimit te ujrave ne qofte se nje shkaterim i tille mund te shmangej nepermjet pajisjeve rezerve;
- d) Shpenzimet e kryera per hermetizimet shtese dhe per pajisjet shtese per shkarkimin e derdhjeve dhe/ose te ujrave te nendheshme;
- e) Demet per shkak te fundosjes se dheut ne qofte se shkaktohet nga kompaktesia e pamjaftueshme;
- f) Plasaritjet dhe rrjedhjet;

Shtojca 105 - Mbulimi për ndërtesat egzistuese dhe/ose pasurinë rrethuese

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të dhe qe i Siguruari duhet te paguaje nje prim shtese, mbulimi sipas seksionit 1 do te zgjerohet sipas klauzolave te meposhteme per te mbuluar demin fizik te paparashikuar dhe te papritur te strukturave te paraqitura me poshte shkaktuar nga / ose e prejardhur prej ndertimit ose montimit te artikullit te siguruar sipas Seksionit 1, si p.sh per shkak te vibrimit, dobësimit ose levizjes se suporteve (mbështetseve), ulja e nivelit te ujrave te nendheshem, hedhja e themeleve, ndërtimi i tuneleve ose operacione te tjera duke përfshirë elementet mbajtes ose nentoken.

Demtimi i ndertesave te deklaruar me poshte do te jete i mbuluar, nese perpara fillimit te puneve kushtet e tyre jane gjetur te kenaqeshme dhe/ose jane marre masat e nevojshme.

I Siguruari do të bëjë me Siguruesin një raport duke deklaruar gjendjet e ndërtesave, përpara fillimit të punimeve

Të mëposhtmet do të përjashtohen:

1. Demin shkaktuar nga, ose që rezultojnë prej gabimeve, mangësive ne projektimin e punëve të kontratës;
2. Dëmi i cili konsiston në të çarët që nuk dëmtojnë si stabilitetin e strukturës, edhe sigurinë e përdoruesve të saj.

Nëse masa të mëtejshme sigurimi do të bëheshin të nevojshme gjatë ndërtimit, atëhere shpenzimet e kryera per keto masa, nuk do te jene te demshperbleyeshme sipas kësaj police.

Strukturat për të cilat kjo shtojcë do të jetë e aplikueshme: _____

Shtojca 106 - Garancia në lidhje me Seksionet

Eshtë rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmblajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të,

preken menjehere dhe nuk do te perjashtojte humbjet apo demet e artikujve te ndertuar ne menyre te rregullt nga nje aksident per shkak te ketij materiali defektoz dhe/ose mjeshterise se dobet dhe/ose projekti te gabuar."

Shtojca 116 - Mbulimi për Punët e Siguruara të Kontratës të Dorëzuar ose të vënë në Shërbim

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Policën e Sigurimit dhe me kusht që i Siguruari të ketë paguar një prim shtesë të pranuar nga ai, sigurimi CAR do të zgjerohet për të mbuluar:

a) Humbjen ose dëmin e pjesëve të punëve të siguruara të kontratës të përfunduar ose të vënë në shërbim në qoftë se këto dëme ose humbje rrjedhin nga ndërtimi i artikujve të siguruar sipas Seksionit 1 dhe ndodhin përgjatë periudhës së mbulimit me sigurim të kësaj shtojce.

Shtojca 117 - Kushte Speciale për shtrimin e Tubave të Ujësjellësit dhe atyre të Ujrave të Zeza

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesit do të dëmshpërblejnë Te Siguruarin për ndonjë humbje apo dem apo përgjegjësi për shkak të përmytjes ose të mbushjes me aluvione të tubave, kanaleve ose puseta velem për gjatësinë maksimale të kanalit të hapur të shprehur me poshte, të germuar pjesërisht apo komplet, për çdo ngjarje dëmi. Siguruesi do të jetë përgjegjës vetëm në qoftë se:

1. Tubat, menjehere mbasi janë vendosur, garantohen në nje menyre të tille nepemjet mbushjeve qe te mos zhvendosen ne qoftese kanali permytet.
2. Tubat, menjehere mbasi janë vendosur, janë të mbyllura në menyre qe te parandalojne futjen e ujit, llumrave dhe te tjera te ngjashme me keto.
3. Kanalet e seksioneve të tubave te testuar janë mbyllur menjehere mbas përfundimit të testimit nën presion.

Gjatesia maksimale: _____ metra

Shtojca 118 - Punimet e shpimit për Pusët e Ujit

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Policë ose të shtuara në të, mbulimi për pusët e shpimit të puseve do të kufizohet në humbjet apo dëmet për shkak të/ose që rezultojnë nga rrezikët e emërtuara më poshtë:

- Tërmeti, vullkani, stuhia.
- Stuhia, cikloni, pembytyja, vershimi, rreshqitja e toke.
- Zmadhimi dhe/ose formimi i kraterëve.
- Zjarri, eksplozioni.
- Rrjedhjet e ujit me origjine Arteziane.
- Humbje e lengut larës, e cila nuk mund të menjanohen nga eksperiencat e njohura.

• Shkatërrimi i vrimes duke përfshirë këtu shkatërrimin e veshjes së jashtme për shkak të presionit anomal ose të shtresave argjilore të fryra, të cilat nuk mund të menjanohen nga eksperiencat e njohura.

Dëmshpërblimi do të llogaritet në bazë të kostos (përfshirë materialet) së shpenzimeve për shpimin e puseve që nga momenti kur fenomenet e para të rreziqeve të mësipërme janë bërë të dukshme dhe pusi duhet të braktiset për shkak të rreziqeve të marrë në sigurim dhe i Siguruari do të përballojë pjesën e zbritëshme prej 10% të shumës së humbur dhe minimumin për çdo ngjarje dëmi siç shprehet më poshtë.

Përjashtime Speciale

Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për:

- Humbjet ose dëmet e pajimeve dhe të pajisjeve për shpimin e puseve (për të cilat kontraktuesi mund të bëjë një sigurim special).
- Kostot e veprimeve shpuesë të çdo lloji.
- Kostot e rikondicionimit dhe veprimeve të pastrimit për të restauruar gjendjen e pusit duke përfshirë këtu të gjitha punët stimuluese (acidizimin, frakturimi etj.).

Shtojca 119 - Pasuria egzistuese e Investitorit ose Pasuria që është në pronësi ose administrim, ruajtje apo marrë me qira nga i Siguruari

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të dhe me kusht që pasi i Siguruari të ketë paguar një prim shtesë, Seksioni 1 i këtij sigurimi do të zgjerohet për të mbuluar humbjet ose dëmet e pasurisë egzistuese të Investitorit ose pasuri që i përkasin ose që mbahen në kujdestari ose nën kontroll nga i Siguruari, të shkaktuar nga ndërtimi ose montimi i artikujve të siguruar sipas Seksionit 1.

Pasuria e Siguruar: _____

Shuma e Siguruar: _____

Siguruesit do të dëmshpërblejnë të Siguruarin vetëm për humbjet ose dëmet e pasurisë së siguruar, por me kusht që përpara fillimit të punimeve gjendja e saj fizike është e mirë dhe janë marrë masat e nevojshme të sigurimit.

Në lidhje me humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vibrimi ose nga zhvendosja ose dobësimi i mbajtësve, Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin vetëm për humbjet ose dëmet si rezultat i shkatërrimit total ose pjesor të pasurisë së

siguruar dhe jo dëmet sipërfaqesore, të cilat nuk e dëmtojnë stabilitetin e pasurisë së siguruar dhe nuk rrezikojnë përdoruesit e saj.

Siguruesit nuk do të dëmshpërblejnë të Siguruarin për:

- Humbjet ose dëmet e parashikueshme duke patur parasysh natyrën e punës ndërtimore dhe mënyrën e egzekutimit të tij.
- Koston për marrjen e masave për parandalimin ose minimizimin e dëmit, të cilat bëhen të nevojshme gjatë periudhës së sigurimit.

Shtojca 120 - Vibrimi, Zhvendosja ose Dobësimi i Mbajtësve

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të dhe me kusht që pasi i Siguruari të ketë paguar një prim shtesë, Seksioni 2 i këtij sigurimi do të zgjerohet për të mbuluar përgjegjësinë që rrjedh nga dëmet për shkak të vibrimit ose dobësimit të mbajtësve.

Me kusht gjithmone që:

- Siguruesit do të dëmshpërblejnë të Siguruarin në lidhje me përgjegjësinë për humbjet ose dëmet të ndonjë pasurie ose toke ose ndertese vetem në qoftë se nje humbje apo dem i tille eshte total ose pjesor.
- Siguruesit do të dëmshpërblejnë Te Siguruarin në lidhje me përgjegjësinë për humbjet ose dëmet të ndonjë pasurie ose toke ose ndertese vetem në qoftë se përpara fillimit të punimeve gjendja e tij është e mirë dhe janë marrë masat e nevojshme për parandalimin ose për përmirësimin e humbjes apo dëmit.
- I Siguruari, në qoftë se kërkohej përpara fillimit të punimeve, do të përballojë shpenzimet për pagatitjen e një raporti në lidhje me ndonjë pasuri toke, ose ndertese të rrezikuar.

Siguruesit nuk do të dëmshpërblejnë të Siguruarin në lidhje me përgjegjësinë për:

- Humbjet ose dëmet e parashikueshme duke patur parasysh natyrën e punës ndërtimore dhe mënyrën e egzekutimit të tij.
- Dëmin sipërfaqesore të cilat nuk dobesojne pasurine, token ose ndertesën dhe nuk rrezikon përdoruesit e tij.
- Koston për marrjen e masave për parandalimin ose minimizimin e dëmit të cilat bëhen të nevojshme gjatë periudhës së sigurimit.

Shtojca 121 - Kushtet e veçanta në lidhje me punët për Themelet në formë Pilotash dhe Muret mbështetës

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesi nuk do të dëmshpërblejë të Siguruarin në lidhje me:

Shpenzimet e kryera

1. Për zëvendësimin ose ndreqjen e elementeve të pilotave ose mureve mbajtës të cilët:

- a) Janë vendosur keq, niveluar keq ose janë shtypur gjatë ndërtimit.
 - b) Kane humbur ose janë abandonuar ose demtuar gjatë nguljes me rrahje ose nxjerrjes së tyre.
 - c) Janë bllokuar nga pajisjet që shërbejnë për nguljen e pilotave ose për perforcimin e tyre kur keto pajisje janë bllokuar ose demtuar.
2. Për ndreqjen e pilotave të gojëzuara që janë të shkeputura ose të liruara nga shtrengimi.

3. Për ndreqjen e çdo rrjedhjeje ose infiltrimi të materialit të çdo lloji.

4. Për të mbushur boshllëqet ose për të zëvendësuar bentonitet e demtuar.

5. Si rezultat i dështimit për të kaluar provën e rezistencës në ngarkese ose ndryshe mosarritja e kapacitetit mbajtës të projektuar të çdo piloti ose element themeli.

6. Për ndreqjen e profileve ose dimensioneve.

Kjo shtojcë nuk do të zbatohet për humbjen ose dëmin e shkaktuar prej rreziqeve natyrore.

Barra për të provuar që kjo humbje ose dëm është i mbuluar do të bjerë mbi të Siguruarin.

Shtojca 124 - Përjashtimi i Rrëshqitjes

Është rënë dakord dhe pranuar që përveç neneve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Policën e Sigurimit ose të shtuara në të, Siguruesi në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për dëmin ose humbjen e shkaktuar në mënyrë direkte ose indirekte nga rrëshqitja e tokës.